



ΕΛΛΗΝΙΚΗ ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑ

Υπουργείο Μετανάστευσης & Ασύλου

E Premte 2 Tetor 2020

DEKLARATË PËR SHTYP

Në funksion portali dixhital për takimet për rinovimin e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare

U vu në funksion portali dixhital, nëpërmjet të cilit azilkërkuesit do të informohen për programimin e takimit të tyre për rinovimin e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare. Tani e tutje rinovimet e kartave do të kryhen vetëm me takime të programuara.

Azilkërkuesit duhet të shtypin numrin e çështjes së tyre në link-un që vijon <https://apps.migration.gov.gr/applicant-card-rv/search>. Menjëherë do të informohen për orën, ditën dhe shërbimin në të cilin do të duhet të shkojnë së bashku me familjen e tyre për të marrë kartën e rinovuar.

Siç është njoftuar tashmë, kartat e kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare janë shtyrë sipas shifrës së fundit të numrit të çështjes së tyre. Por për të marrë kartat e rinovuara do të duhet të shkojnë pranë shërbimeve pasi të jenë informuar nga link-u i mësipërm për takimet e paracaktuara të tyre. Veçanërisht:

- a. Vlefshmëria e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, të cilat korrespondojnë me numër të çështjes së azilit, i cili mbaron me shifrën "1" shtyhet deri më 6 Nëntor 2020
- b. Vlefshmëria e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, të cilat korrespondojnë me numër të çështjes së azilit, i cili mbaron me shifrën "2" shtyhet deri më 13 Nëntor 2020.
- c. Vlefshmëria e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, të cilat korrespondojnë me numër të çështjes së azilit, i cili mbaron me shifrën "3" shtyhet deri më 20 Nëntor 2020.
- d. Vlefshmëria e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, të cilat korrespondojnë me numër të çështjes së azilit, i cili mbaron me shifrën "4" shtyhet deri më 27 Nëntor 2020.

e. Vlefshmëria e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, të cilat korrespondojnë me numër të çështjes së azilit, i cili mbaron me shifrën "5" shtyhet deri më 4 Dhjetor 2020.

f. Vlefshmëria e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, të cilat korrespondojnë me numër të çështjes së azilit, i cili mbaron me shifrën "6" shtyhet deri më 11 Dhjetor 2020.

g. Vlefshmëria e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, të cilat korrespondojnë me numër të çështjes së azilit, i cili mbaron me shifrën "7" shtyhet deri më 18 Dhjetor 2020.

h. Vlefshmëria e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, të cilat korrespondojnë me numër të çështjes së azilit, i cili mbaron me shifrën "8" shtyhet deri më 29 Dhjetor 2020.

i. Vlefshmëria e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, të cilat korrespondojnë me numër të çështjes së azilit, i cili mbaron me shifrën "9" shtyhet deri më 7 Janar 2021.

l. Vlefshmëria e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, të cilat korrespondojnë me numër të çështjes së azilit, i cili mbaron me shifrën "0" shtyhet deri më 14 Janar 2021.

Vlefshmëria e Kartave të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, të cilat janë lëshuar dhe për rinovimin e të cilave është kompetente Zyra Rajonale e Azilit të Lesvos, shtyhet deri më 14 Janar 2021.